



CMYK

BOTIM I "NACIONAL GRUP"

VITI I I BOTIMIT, NR. 4

ÇMIMI 30 LEKË / 0,50 EURO

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# nacional

Drejtor:  
Mujë BuçpapajAdresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com bucpapaj@yahoo.com**REPORTAZH**

Përurohet kthimi në identitet të Piacës së Shkodrës

## "Në Shkodrën tonë ka ra një ditë"



## 22 marsi, dita më e rëndësishme e historisë së re të Shqipërisë

## EDITORIAL



### Shqiptarët në NATO

nga Mujë BUÇPAPAJ

Vetëm pak ditë e ndajnë Shqipërinë nga anëtarësimi zyrtar i saj në NATO. Tashmë shqiptarët në Ballkan janë një komb pjesëtar i Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe ky është një fakt kuptimplotë. Shqipëria e futur me vull dhe energji drejt pluralizmit dhe demokracisë në fillim të viteve '90, ka pritur me padurim konfirmimin e vullnetit të saj popullor për t'u anëtarësuar në organizatën më të madhe të sigurisë në planet.

NATO është e pranishme në Ballkanin Perëndimor dhe shqiptarët kanë një histori të suksesshme bashkëpunimi me të, por anëtarësimi i Shqipërisë në këtë strukturë do të përgadiste Forcat e Armatosura të vendit për të marrë përgjegjësi më të medha për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Një rajon si Ballkani, i dalë prej luftrash etnike dhe spastrimeve të egra, ka nevojë jetike për praninë e NATO-s dhe të SHBA-ve. Është shumë e rëndësishme që vende agresive si Serbia, e cila i krijoi tragjedi të medha rajonit, duke përfutur edhe nga fuqia e saj ushtarake, t'i ndërtohet një digë e forte, e pacenushme, në mënyrë që ai vend të heq dorë nga projektet agrsive, kolonialiste ndaj fqinjëve. Dhe kjo digë janë shqiptarët në NATO.

Rritja e sigurisë do të rikthente vemendjen e investitorëve të medhenj në hapsirat shqiptare, të pasura **vijon në faqen 2**



### SI TË NDALET BASTARDIMI NË MUZIKË?

nga Lindita SEJDIU, Shkup

Gjendja e muzikës shqipe është skandalozë. Kemi frikë të shkojmë në Turqi, apo Greqi gjatë verës, se mos dëgjojmë versionin original të ndonjë këngeje shqiptare. Muzika e vjedhur, dhe këngëtarët diletantë janë bërë tashmë një fenomen. Diçka që të vret veshin gjithnjë e më shumë në muzikën shqiptare janë nuancat orientale, greke, bullgare, sllave që e kanë kapë atë, e për më tepër gjoja "përpunimi modern" që i bëhet këngëve popullore që në fakt po e vrasin muzikën popullore. Duhet të hiqet dorë nga paraqitja vulgare në muzikë. Sot kërkohet thjeshtësi dhe bukuri që të ketë një kuptim ajo që dëgjon dhe kjo s'mund të vijë aspak prej teksteve banale, që po i dëgjojmë dendur në radio e televizion. Është e papramëshme tendenca e deformimeve, që i bëhen muzikës prej **vijon në faqen 2**

## NJËQIND GRA PËR NJËQIND VJET...



### JULIA ROBERTS DËSHIRON TË GATUAJË PËR BARAK OBAMËN

### PILOTI SHQIPTAR, XHEJMS BERISHA, LOBON ME AEROPLAN NË 30SHTETE TË AMERIKËS LATINE E QENDRORE

nga BEQIR SINA, New York

**Të njihet Pavarësia e Kosovës!**

LEXONI faqe 20



## Në BRENDËSI

**MBI ARRITJET LETRARE TË FREDERIK TURNERIT**  
Nga GJEKË MARINAJ

faqe 16-17

**PREKJE LIRIKE për Presidentin Rugova**  
nga ALMONA BAJRAMI

faqe 11

**U TAKUAM NË PASQYRË**  
Poezi nga Petraq RISTO

faqe 4-5

**KAFSHIMI I DURIMIT**  
Tregim nga Ylli XHAFERRI

faqe 6

**PRIRJA DREJT HOMOGENIZIMIT ETNIK TË VENDEVE TË BALLKANIT**  
Prof. dr. SABRI LAÇI

faqe 11

*Poezi* nga LULZIM LOGU, NAIM KELMENDI, DASHAMIR MALO, MILIANOV KALLUPI*Prizë* nga MICHAEL ENDE, GANI MEHMETAJ, MIMOZA EREBARA, XHAHID BUSHATI**Kopështi shkëmbor i Europës Juglindore**  
nga MORELLE SMITH

faqe 22

# Reflektime MBI ARRITJET LETRARE TË FREDERIK TURNERIT



Nga GJEKË MARINAJ



Frederik Turner dhe Mujë Buçpapaj, në shtëpinë e Gjekë Marinajt në Dallas, SHBA

Frederik Turner (Frederick Turner) filloi të botojë që në vitet 60-të kur ishte adoleshent. Atëherë koncepti i poezisë dominohej kryesisht nga një formë e përcaktuar, vargje lirike të shkurtra, të lira, imagjinatave dhe ekzistencialiste në vetën e parë. Turneri është një ndër poetët më esencial që ka zbuluar gamën e formave dhe zhanreve të lira për poetët bashkëkohorë.

Për dominimin e poezisë me vargje të lira plotësisht personale ekzistonin arsye të forta. Qeveritë totalitare në shumë vende të botës e kishin korrupsionin mendim publik dhe kishin hedhur dyshim mbi traditat e njohura të së kaluarës së njerëzimit, duke lënë vetëm zërin sekret të poetit si vendin e sigurt për të thënë të vërtetën. Në botën demokratike shumica e poetëve u veçuan nga kultura e njohur komerciale që kishte paracaktuar llojet e bukurisë formale dhe vinte në përdorim shembujt banalë prej fjalimeve publike, që i detyronte të gjenin zërin e fshehtë e të pa ndërmjetësuar, si të vetmen formë të plotë të komunikimit. Specializimi shkollor i la shumë prej poetëve pa njohuri për sa i takon gjerësisë së diturisë njerëzore, duke hequr menjëherë letërsinë moderne, ndaj për këtë atyre u duhej të shtridhnin jetën e tyre private për të nxjerrë materiale poetike. Pedagogët nuk kishin kohë apo durim t'u mësonin disiplinën strukturore të metrikës dhe formës në poezi gjersa edhe ajo kishte kohë që kishte dalë mode. Përmbi të gjitha, arritjet e mëdha të poetëve romantikë dhe modernistë në përdorimin e formave të shkurtra autobiografike në poezi bënin ftesa për ta imituar atë.

Në librin e parë, përmbledhje me poezi, të Turnerit, "Ndërmjet dy jetëve" (Between two lives), jepet kalimi nga stili i atëherëshëm bashkëkohor i poezisë "rrefimtare" drejt një interesi të ri për poezinë narrative. Në atë kohë Turneri që vlerësuar plotësisht për vargjet rrefuese të cilat ishin dendësisht të krijuara me imazhe sureale dhe adresime të drejtpërdrejta. Ai ishte bërë mjeshtër vetëm në një zhanër, për t'u kthyer pastaj tek të tjera. Poemat e tij narrative me subjekt çuditërisht të shkurtër dhe me vendndodhje tepër të pa qarta ndikuan tek poetët e tjerë amerikanë. Ai kishte treguar se si aluzioni letrar, ekonomia narrative tronditëse e Borgesit dhe pasioni ireal si në ëndërr, do të shpreheshin kështu në fushën e poezisë:

Në kodrën e fshatit, pingu i dheut

lufton me kortezhin,

Vajza e liqenit takohet me të përmes një letre.

Një flokë kaçurreli i bie mbi sy, ca quka, një pallto e shkurtër. Mendon

se dikush po përpigjet t'i vrasë shokun.

Libardi shtrëngohet. Atë natë një prej të fortëve merrej me ngarkesën e vogël e cila qe disa kilometra nga pylli, ku i gjetën plumbin në brinjën e dytë.

Histori e vjetër e Kainit, siç thotë edhe polici, ku për veten e tij, filmi regjitet një çast, duke kaluar tek bobina tjetër.

Poema "Dy jetët" nga titulli nuk sugjeronte vetëm dy jetët e Turnerit si anglez dhe amerikan. Ajo e paraqiste jo vetëm si një mësuës të ri, të respektueshëm, ëndërrimtar dhe të shqetësuar, por edhe si dy jetët e poetit rrefimtar bashkëkohor dhe të poezisë novatore me vargje të lira, në të cilën që atëherë bota reale jashtë natyrës së vet ishte më e pastra për poetin.

Tashmë ai nisi një model krijues të poetit i cili ishte në shumë aspekte revolucionar për kohën si ballë për ballë, por edhe për shkak të dëshirës për t'u vendosur me modelet e poetit të së kaluarës. Poeti, pas Turnerit nuk do të jetë në gjendje të përshtatë rolin e anti-heroit të veçuar pa dyshimet reale, ku ndoshta fusha e lirë ende do të mbetej e shfrytëzuar nga poezia.

Turneri filloi të mbrojë botën e lirë demokratike kapitaliste, ashtu siç ishte me shtrirjet e saj, si tek poezia *Counter-Tarza* ku në përmbledhjen tjetër poetike, ai mori si metaforë kryesore gjeografine e Dizneit Lëndit dhe zbuloi shumë zëra ndryshe nga zëri i tij. Ai mësoi të kuptojë përforsimin e metrikës dhe e përdorte për t'u shmangur kufizimeve të zërit të tij dhe shprehjeve arketip të teknikës, në një nga poemat e tij lapidar si në lojën Shah dhe Mat:

Shahu si truri i perëndimorëve bën

drurin të flasë

Paradigmë abstrakte që nuk rrjedh prej druri, shkon gjithë forcë e gëzim ku merr shpirtin tek gurët e thjesh-të dhe shah.

Metafizikë që fluturon mbi fushën, ku mbërthehen trupa të pajetë. Vepra e duarve të lindorëve që nuk preken kurrë prej fjalës së mishëruar.

Ekspursionit praktik i Turnerit drejt aplikimit me saktësi të formave metrike u pasurua sipas studimeve teorike dhe akademike të tij ndaj tyre. Eseja e tij e famshme (bashkëpunim me neurologun e njohur gjerman, Ernst Pöpel) të titulluar "Lira neurotike: Metrika Poetike, Truri dhe Koha," mori Çmimin e njohur "Levinson" në revistën "Poetia", me të cilën hodhi themelet shkencore të formës poetike dhe transformoi poezinë amerikane. Kjo solli edhe një shpjegim koherent se përse forma metrike ishte më shumë se një traditë kulturore vendore, ajo përbente kapacitetin njerëzor universal si melodia, piktura dhe gjuha. Në atë kohë dolën dy lëvizje poetike, "formalizmi i ri" dhe "narrativi i ri", që të bashkuara njihen me atë që quhet "poezia e zgjeruar" (Expansive Poetry). Brenda këtyre lëvizjeve lindën talente të reja si: Dana Gioia (Drejtoreshë e Trashëgimisë Kombëtare të Arteve) dhe talente më të mëdhenj si: James Merrill, John Frederick Nims, Anthony Hecht të cilët morën nderin që meritonin. Le të citojmë nga "Lira Neurotike";

Kjo do të thotë se ndryshimet metrike nuk janë shumë të rëndësishme në vetvete, si semema, po mbi të gjitha krijojnë së bashku një pikturë si tek Gjestalt që është një nga ilustrimet e njohura të asaj që njohim dhe ashtu sikurse simbolet grafike apo muzika, ato janë pak a shumë më të lidhura me kulturën, se sa janë kodet e gjuhësisë. Por këtu në mënyrë kreative

hasim një paradoks që kufizohet nga përbërje groteske të mendjes njerëzore. Poezia duke qenë se është arti i gjuhës mbetet pa dyshim i drejtuar nga lobi i majtë, i përkohshëm i trurit. Por, ne sugjerojmë se metrika mbart kuptimin në një farë mënyre më shumë si tablo e melodisë, në të cilin kuptimi është i pranishëm më tepër për të tërën, se sa pjesërisht. Për këtë nuk ka "leksik" të formave metrike, ato nuk janë kode të fshehta, por elemente të një përbërje analogjike. Ndaj ky lloj arsytimi njihet se zë vend në lobin e djathtë të trurit. Nëse hipoteza të tilla janë korrekte, metrika është pjesërisht mënyra për të ndërlidhur më tepër bashkëpunimin tonë kulturor (dhe ndoshta më vonë në mënyrë progresive) aftësitë linguistike janë përkatësisht më tepër për vlerësimin e "lidhjeve të forta" të formave universale të dhuntive që komunikojmë me gjetarët më të përparuar.

Kjo është në kontekstin e kësaj hipoteze ku synojmë të paraqesim vendimin më të lartë rreth kësaj eseje me të cilën interpretohet se ne besojmë në njohjen e jashtëzakonshme të 3 VARGJEVE të dyta të poezisë njerëzore.

Duke qenë revolucionare në vetvete, kjo përbente faktin se një poet do të mund të shfrytëzonte në studimin e tij të rëndësishëm shkencor, në themele të artit të tij, diçka e cila ishte e padëgjuar që gjatë kohës së Gëtes. Emrin e Turnerit dhe arritjet e tij shkencore mund t'i gjeni në veprat me referenca kryesore shkencore. Ashtu si poetët e tjerë; Valery, Coleridge dhe Eliot, Turneri ishte, gjithashtu, një nga kritikët kryesor të këtij koncepti. Në veprën e tij të parë, "Shekspiri dhe Natyra e Kohës", ai kishte ndërtuar reputacionin e tij, ku disa prej eseve dhe shkrimeve të tjera logjike e kishin forcuar si poet. Por Turneri po rigjallëronte traditën e poetit, si mjeshtër i plotë i figurave të rëndësishme të kulturës moderne, duke pasur këta

poetë si shembuj: Homerin, Virxhilin, Shekspirin dhe Miltonin dhe në shekullin e 20-të kjo mjeshtëri përfshinte njohjen sistematike të shkencave. Me sa dimë kjo e çoi Turnerin drejt përm-bushjes. Midis poetëve të shekullit të 20-të, Turneri lidhet me grupin absolut të inteligjencës, ndoshta vetëm me Ezra Pound dhe Jorge Luis Borges.

Në librin poetik "Kopshti" (i konsideruar si një prej librave më të rëndësishëm) Turneri të vazhdojë studimet e tij drejt një mediumi që do të restauronte fuqinë e vjetër intelektuale dhe shpirtërore të poezisë. Nga kombini-mi i poezisë me prozën depërtohet drejt thellësisë dhe unikalitetit të vizionit filozofik dhe shkencor të botës, duke lartësuar atë vizion poetik që mbart pasion, ndjeshmëri dhe spontanitet. Në thelb ai natyralizon teologjinë dhe e mishëron atë në terma shkencore duke i përkthyer studimet përmes një fenomenologjie poetike pa ndërmjetësi.

Në fund të viteve 70-të, Turneri së bashku me Ronald Sharp, një nga kolegët e tij në Universitetin Kanion dhe tani Dekani i Fakultetit në Universitetin Vasar, ribotoi Revistën Kanioni (*Kanyon Review*) e humbur deri atëherë, e cila nisi si një nga periodikët më të shitur të John Crowe Ranson, Allen Tate, Robert Penn Warren dhe Agrarët. Ata e shndërruan atë në revistën më të suksesshme ndërdisiplinore letrare, që nxiste shembujt më të vjetër të qytetarisë letrare me emra të njohur si: Locke, Gibbon, Darwin dhe Adam Smith që ishin në të njëjtën kohë në vendin e tyre si poetë, kritikë dhe shkrimtarë, ashtu siç është mediumi për zbulimet e reja letrare. Përmirësimi i shkrimeve shkencore dhe për natyrën ashtu siç njihen nga zhanret letrare mund në një mënyrë apo tjetër t'i takojë arritjeve të tyre. Në revistën Kanioni, poetët formalë dhe narrativë zunë vend, ku përfshinte në të vërtetë pothuajse gjithë brezin e poetëve të mëdhenj që botonin në etapat e para të karrierës së tyre. Sipas pikëpamjes së Revistës Kanion të njohur për rilindjen e shkrimeve amerikanë dhe perëndimorë dhe për kujdesin e veçantë kushtuar letërsisë klasike të Amerikës Latine dhe Azisë, ajo kritikonte teoritë moderniste dhe post moderniste të origjinalitetit artistik dhe risinë thjesht ndryshuese "duke u hedhur mbi mbeturinat". Në një nga thëniet pragmatike të Çurçillit mbi rritjen bërthamore u transformua në modë kulturore dhe kështu u propozua riformulimi i humanizmit për shkencat natyrore dhe shoqërore.

Parathënia e poemës së parë epike të Turnerit "Bota e Re", përmbledh po ato interesa ashtu sikurse i kuptonte, në përpjekjen e tij poetike për të shëruar shpresën dhe qëllimin për të zgjedhur gjatë Luftës së Ftohtë:

Qëllimi kryesor i poemës "Bota e Re" (New World) qëndron në para-

**Arti i përkthimit është një nga vlerat më të fuqishme të poetit dhe në të njëjtën kohë shërben edhe si mënyra me të cilën poeti shlyen pjesërisht borxhin e madh që ka ndaj poetëve të tjerë botërorë, qofshin ata të gjallë apo të vdekur: Frederik Turner është edhe një nga dhuruesit e mëdhenj në teorinë e përkthimit, i cili ka dhënë për të prishur përmes një kundërshtie të madhe temën sipas arsyetimit të modernizmit dhe post modernizmit.**

qitjen e së ardhmes realiste njerëzore, histori të mundshme, edhe pse jo të përsosura që kalojnë përtej horizontit aktual të thjeshtësisë letrare dhe holokaustit bërthamor. Arti ndihmon në shpëtimin e botës për ndërtimin e shpresave të reja të imagjinuara që nuk përfshijnë Goterdamerungun e vetëvrasjeve masive, sepse në se nuk do të kishte të ardhme të imagjinuar, me të vërtetë do të zgjidhnim shkaterimin, do të mbeteshim ashtu siç jemi tani, krijesa të imagjinatës.

Po të mendojmë se poema ka këtë qëllim, kjo do të thotë që të ecim një hap përtej vargjeve të lira të poemave lirike ekzistencialiste imagjinatave që përbëjnë periudhën moderniste të letërsisë. Kësaj periudhe ndoshta po i vjen fundi, deri diku për shkak të ideve të saj, siç janë edhe vet ato, nxitëse dhe frymëzuese, të cilat nuk do të na mbronin dot prej kërcënimit për t'u vet-shkatërruar. Poema "Bota e Re" është epike dhe ka si qëllim të shërbejë si epoka krijuese e post - modernizmit.

Ndoshta poemat epike të Turnerit dhe poemat e gjata narrative janë ndihmesa e tij më e madhe në art përsa i takon poezisë dhe ndikimit në përgjithësi në shoqëri. Zgjedhja e zhanrit përbën karakteristikën e gjestikulacionit. Ai ripërtërin formën e vjetër, por jo vetëm formën analogjike apo alegorike, si p.sh tek Cantos e Pound, Ulises i Joyce-it, por edhe serinë e plotë të makinerisë epike që përfshihin risinë, formën e vargut të rregullt, fillimet në *medias res* personazhet kryesore epiko-dramatike, alegorinë epike dhe organizimin e subjektit që përbëhet nga konflikti i njohur. Ai nuk i pranon vlerësimet e kritikëve se ka kaluar koha e epikës dhe tani ka ardhur koha e romanit. Zgjedhja për epikën nuk është thjesht sfidë formale drejt teknikës moderniste, por është një vlerësim aktiv se ka ende gjëra të mëdha për t'u përbushur nga njerëzit, se bota nuk është përfundimisht e marrë fund, se ende ka ideale që mund të nxisin njerëzimin që janë më të forta se seksit dhe vdekja. Turner e ruan "intervalin epik" midis krijimit të një poeme dhe temës së saj, e cila shkon disa shekuj në të kaluarën, por në këtë rast, tema është në të ardhmen dhe ai e konsideron si epike, si poet i epikës së të ardhmes me qëllime artistike dhe historike.

Turneri gjithashtu ka nxitur vlerësimin për post modernizmin se nuk do të ketë më: "narratorë të mëdhenj". Sigurisht ai kërkon të njohë mendimin e pastër të narratives klasike eurocentrike, duke hedhur si bazë etimologjike nga tradita kineze, japoneze, indiane, afrikane dhe kolumbiane, si dhe evropiane, por ndërkohë vepron kështu për të gjetur material historik të marrë plotësisht nga njerëzit, por jo për të përafuar dhe shformuar gjithë përshkrimin. E nesërmja që krijon i përket njerëzores, por jo vetëm pjesë

perëndimore, por edhe familjes nga Bota e Re, mbi të gjitha të një bote krejt ndryshe si tek "Zanafilla" (Genesis). Ai koncepton statutet e ardhshme politike, të cilat jo vetëm që nxjerrin zakonet evropiano - amerikane të demokracisë dhe tregut të lirë, por edhe elementë të sistemit social, socializmit dhe anarkisë demokratike. Teknika e tij rrjedh më tepër nga puna në kopshitari, zanati dhe disiplina fetare e "botës së tretë" si dhe njohja "perëndimore" për realizimin e plotë të jetës.

Në një nga përmbledhjet e njohura me monografi dhe ese, Turner sjell filozofinë me të cilën mbështet akuzat e maskuara të poezisë së tij. Klasicizmi Natyral emërtion shkaqet shkencore të teorisë së performancës artistike, antropologjike dhe teorike të metrikës poetike. Tek "Rilindja e Vlerave" është duke ndjekur metodën kryesore estetike, konservatorizmin, arsimimin dhe fenë. Tek "Stuhia, Flauti dhe Ozi", titulli i të cilit përfaqëson një ese të rëndësishme, ku lidhen dramat "Stuhia" tek Shekspiri, "Flauti magjik" tek Moxarti dhe një prej filmave të njohur "Magjistari i Ozit" është një nga përmbledhjet e eseve mbi të ardhmen me këto tema: globalizmi, kolonializmi hapësinor, inteligjenca artificiale dhe komunikimi i së nesërmes. Në veprën "Kultura e së Ardhmes", Turner tregon se si idetë e tij do të mund të ndërhyjnë dhe ndryshojnë "luftën tradicionale" të së majtës dhe së djathtës dhe të nxisë artistët të shohin përtej pikëpamjeve të vjetra të modernizmit të kohëve të fundit dhe post modernizmit, duke sugjeruar pozitivistisht shumë se sa negativisht ndaj feminizmit, post - kolonializmit dhe konservatorizmit. Ndërsa në veprën "Ekonomia shekspiriane e shekullit njëzet e një" (Shakespeare's Twenty - First Century Economics), Turner bën të njohur vendosjen e natyrës së etikës në tregun kapitalist.

Në shfrytëzimin e esesë dhe monografisë fetare si një nga zhanret letrare, Turneri ndërmerr përgjegjësinë, jo vetëm për stilin letrar, por edhe për cilësinë e përmbajtjes që mund të konkurrojnë me gjerësisht me tregun e ideve jo letrare. Ai jo vetëm që këmbëngul për bashkimin e kulturës (kundër zgjidhjes post moderniste për sa i takon fragmentarizmit dhe qarqeve të mbyllura hermetike), por edhe qëllimin njohës të poezisë si në rastin kur hipotezat imagjinatave për të ardhmen reale të njerëzimit krijohen dhe provohen për koherencë dhe përsosje artistike. Duke e bërë të qartë teorinë e plotë dhe analizën pas vargjeve më të thjeshta dhe të ndërlikuara të poezisë së tij, ai lidh traditën e poetëve të lirë e të njohur si: Milton, Gëte dhe Dante.

Bindja e Turnerit tregon, jo vetëm thjeshtësinë e tij harmonike dhe gjuhën fetare, por edhe lehtësinë e tij në zhanre të tjera letrare. Secila nga përmbledhjet e vogla me tregime qëndron unikale dhe nxitëse për zhanrin. Në

romanin e tij fantastik shkencor, "Hije e dyfishtë" (Double Shadow), i cili u botua, jo vetëm në Amerikë dhe Angli, por edhe u përkthye në frëngjisht dhe japonisht, mbetet një nga studimet e hershme klasike të temës së kolonializmit në planetin mars duke kundërshtuar dhe kritikuar plotësisht studimet nga Ray Bradbury dhe Robert Heinlein. Dy dramat e vëna në skenë të Turnerit janë: "Lartësi" dhe "Lutjet e Dallasit" (Height and The Prayers of Dallas), të cilat qenë jashtëzakonisht të suksesshme në skenë. Konflikti satirik në këtë vepër për barazinë burokratike dhe ideologjike e bëri të diskutueshëm, ndërsa përfshirja etnike dhe teologjike tek drama "Lutjet" ndezi diskutime të nxehta dhe të gjalla në qytet. Poezia satirike e Turnerit e bëri "poet cilësor" me një nga përmbledhjet e veçanta në revistën "Drita", një nga revistat kryesore në Amerikë për vargjet e thjeshta. Poema e tij e gjatë "Balada e Kaubojit të Mirë" zë vend pas "Poezisë për Kaubojin" nga Robert Service dhe të tjerë si në shfrytëzimin e tij përmes fantastikës e shkencës, ku Turneri nuk i frikësohet zhanreve të njohura duke mos pranuar konsideratën ndaj tyre për termin "nën letrar".

Gjatë Luftës në Irak, Turner mbajti qëndrim të vendosur në mbështetje të regjimit Batist dhe vendosjen e sistemit të lirë zgjedhor. Praktika e tij e hershme si "komunist" dhe pakënaqësitë shqetësuese, plus edhe virtyti totalitar, e kishin parajgykuar fuqishëm kundër qeverisjes jo përfaqësuese të cilën e konsideroi thjesht si forcë e kapësit rob më shumë se sa viktimën e tij, ku rob përbente gjithë kombin. Si demokrat optimist, Turner nuk e njihte autonominë e qeverive të tilla dhe nuk kishte asnjë lidhje me ligjshmërinë e luftës që do të shpëtonte robërit nga kapësit e tyre. Njohja e tij në lidhje të ngushtë me disa nga heronjtë e revolucionit hungarez kundër sundimit sovjetik në vitin 1956, e bëri atë të ndjehet me turp për atë që e konsideronte se ishte tradhtia e Perëndimit për popullin përballë një teme të tillë dhe dashuria e tij që nga fëmijëria për Afrikën, për shtetin Zambia, e ktheu atë në njëri veçanërisht të ndjeshëm, sidomos prej largimit nga Ruanda.

Edhe pse e drejtë apo e gabuar, Turner luajti një rol të rëndësishëm në diskutimin që u ndez në Amerikë mbi njohjen dhe të drejtën e luftës. Ai ishte i vetmi poet i madh që mbështeti publikisht luftën dhe ishte mbi të gjitha pothuajse i vetmi në botën e njohur zyrtare. Poema e tij indinjuese, "Përgjigje drejtuar pesëmijëve" citonte përgjithësisht, hidhte në diskutim dhe shpallte turpin ndaj profesionit të tij, se në se "poeti" mbart përmes poezisë testin ideologjik të litmusit, edhe poetët do ta marrin në konsideratë se kanë për të nënshkruar së bashku pozicionin e tyre në grup apo t'i largohen atij. Në fakt më shumë se



dhjetë mijë poetë të vet identifikuar nënshkruan denoncimin e luftës. Turneri e vlerësoi këtë si pasojë e asaj që Czeslaw Milosz e quajti "ndërgjegjja e Kitmanit", e cila ishte marrëveshje skeptike. Kundërshtimi i tij nxiti një numër gjithnjë e më të vogël të poetëve të cilët shprehën paktin e tyre me të dhe me shembullin e tij u hap pista për diskutime të lira.

Arti i përkthimit është një nga vlerat më të fuqishme të poetit dhe në të njëjtën kohë shërben edhe si mënyra me të cilën poeti shlyen pjesërisht borxhin e madh që ka ndaj poetëve të tjerë botërorë, qofshin ata të gjallë apo të vdekur. Frederik Turner nuk mbetet vetëm një përkthyes i famshëm, por ai është edhe një nga dhuruesit e mëdhenj në teorinë e përkthimit, i cili ka dhënë për të prishur përmes një kundërshtie të madhe temën sipas arsyetimit të modernizmit dhe post modernizmit. Bashkëpunimi i Turnerit me Zsuzsanna Ozsvath (një nga të mbi-jetuarat e holokaustit, pianiste në koncerte dhe studiuese e njohur e letrave dhe Holokaustit) kishte nxjerrë dy përmbledhje me përkthime të jashtëzakonshme në gjuhën hungareze, "Qielli i Shkumuar" (Foamy Sky): Poemat kryesore të Miklos Radnotit dhe "Katakombi i Prangave të Nxira" (The Iron-blue Vault): Poema të përzgjedhura nga Attila Jozsef. Turneri dhe Ozsvath fituan Çmimin Milan Fust, një nga çmimet letrare më të njohura, për veprën e tyre.

Turneri diskutoi se çdo poet gjatë procesit të krijimtarisë duhet të përballë me problemin e përkthimit. Koncepti origjinal i poemës mund të ketë pak fjalë dhe në se ato lidhen do të përbente një përmbledhje të imazheve, të përvojave të kujtuara apo

të mundshme, të përshtypjeve dhe veprimeve, ndjesive, emocioneve dhe mendimeve të pathëna, si dhe qëllimet. Poeti së pari duhet të përkthejë këtë koncept në gjuhën e tij "të gjuhës fjalën" ashtu siç e ka thënë poeti. Turneri e kuptoi mediumin e parë të poemës, para se të kalonte në gjuhën e folur apo të shkruar, si pjesë e gjuhës së tij, ashtu sikurse Ozsvath e pagëzoi me emrin "ur-language". Kjo përbente gjuhën e ëndrrave, e njohjes së krijësive të tjera më të larta, e fëmijëve para se ta flasin atë. Ajo ishte kryesisht ritmike, e bashkuar dhe shqisore. Më e rëndësishmja nga të gjitha u diskutua midis shteteve dhe kulturave të njerëzimit.

Sipas teorisë së përkthimit bashkëkohor, pjesa më e madhe (mbështetë në shpërbërjen e pjesëve hermetike), ku çdo gjuhë natyrale përbëhet nga një qark i mbyllur hermetik. Të gjitha fjalët sipas leksikut përkufizohen me terma të dallimeve, me fjalë të tjera kuptimeve nga fjalori dhe asnjëra prej tyre nuk mund të shihet jashtë kontekstit, përderisa renditja e tyre përbën pothuajse arritje gjuhësore. Meqenëse po flasim prerazi, përkthimi është padiskutim apo së paku disi me fyerje siç thuhet edhe në italisht "traduttore é traditore" që do të thotë përkthyesi është tradhtar.

Teoria e përkthimit të Turnerit nxjerr me pjekuri këtë lloj çështje, duke kuptuar se puna e përkthimit dhe në të vërtetë formulimi i çfarëdo mendimi dhe qëllimi në gjuhën kombëtare, në identitetin kryesor është pothuajse një formë "tradite". Atëherë puna e përkthyesit shërben për t'i dhënë formë teknikës me të cilin fjalët e poetit

vijon në faqen 20

PILOTI SHQIPTAR, XHEJMS BERISHA, LOBON ME AEROPLAN  
NË 30 SHTETE TË AMERIKËS LATINE E QENDRORE

**Të njihet Pavarësia e Kosovës!**

nga BEQIR SINA,  
New York

**El - Paso Teksas :** Një lajm i gazetës "El - Diario" që botohet në gjuhën spanjolle ka tërhequr vëmendjen e opinionit dhe mediave amerikane jo vetëm në Texas. Lajmi tanimë ka marrë "dheun", dhe të gjithë janë duke pritur me kureshtje, ditën -kur aeroplani që do të tërheqë pas vetes një banderolë të shkruar në spanjollishte dhe anglishte: "Të njihet pavarësia e Kosovës". Kjo gazetë shkruan me shkronja më mëdha se " James Berisha, Residente De El Paso - Es El Embajador " No Oficial " De Kosova (Xhejms Berisha, banori i El -Pasos - Është ambasadori "Jo zyrtar" i Kosovës")



Ish-presidenti Klinton me James Berishen

Gazeta "El - Diario", shkruan se " Një banor i qytetit të El Pasos në Teksas, migruar nga Kosova, me profesion pilot, po planifikon të fluturojë në të gjithë pjesën e kontinentit të Amerikës Latine, që përfshijë 30 shtete. Këtë ai do ta bëjë duke fluturuar në një lartësi jo shumë të lartë, nëpër hapësirën ajrore të disa shteteve të Amerikës Qendrore dhe Amerikës e Jugut, shtete të cilat deri tash nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur.

Ky lloj lobimi i rralë dhe i pa parë deri më tash për njohjen e pavarësisë së Kosovës, bëhet me qëllim që të gjithë ato shtete mbi të cilat do të fluturojë aeroplani i drejtuar prej tij, e të cilat nuk e kanë njohur deri tash njohjen e pavarësisë së Kosovës, të inkurajojnë për njohjen e shtetit më të ri në botë, Republikën e Kosovës . Ky lobim me aeroplan do të bëhet nga piloti Xhejms Berisha . Lobimi apo fluturimi do të bëhet në fund të marsit. Të këtij viti

Xhejms Berisha, pilot 37 vjeçar nga Bestrovia, e Kosovës, është duke planifikuar të fluturojë me aeroplanin e tij, vetëm me një motor. Nisja do të kryhet nga aeroporti i qytetit El Paso, në Teksas, në fund të marsit, dhe do të përshkruajë më shumë se 30 vende, në mbështetje për të njohur pavarësinë të Kosovës, e cila u bë shtet i pavarur në 17 shkurt të vitit 2008

**Kështu shkruan gazeta prestigjiozja "El - Diario".**

Xhejms Berisha dëshiron që të tërheq vëmendjen edhe të qytetarëve të këtyre shteteve për njohjen e shtetit të pavarur të Kosovës. Këta qytetarë të këtyre shteteve do të shohin aeroplanin me banderolën "Të njihet pavarësia e Kosovës", dhe më pas ata mund të informojnë sa më parë qeveritë e tyre për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Mirëpo sipas gazetës El - Diario, Berisha ka edhe një qëllim tjetër, që njerëzit anembanë botës kur të dëgjojnë këtë lajm, të dinë se kush është shteti i Kosovës dhe se çfarë njerëzish ka Kosova dhe se çfarë janë në gjendje të bëjnë ata për Kosovën.

Me një fjalë, ai dëshiron t'u tregojë këtyre vendeve se çka është në gjendje të bëjë një banor i Kosovës për shtetin e vet. Çfarë është në gjendje të bëjë edhe një pilot, profesional i lindur në Kosovë, dhe emigruar në SHBA-së, për vendin e tij, Republikën e Kosovës.

Vetë, piloti nga Kosova , Xhejms Berisha , citohet të këtë thënë se: "Unë do të falënderoj të gjitha ato vende që deri tash kanë njohur pavarësinë e Kosovës, dhe unë do të bëj udhëtimin tim në hapësirën ajrore të 30 shteteve të Amerikës Qendrore e Jugore, dhe me këtë dua të tregoj se sa e rëndësishme është që Kosova të jetë e njohur në mbarë botën"

Xhejms Berisha, kaloi fëmijërinë e tij në Kosovë, pastaj ai e nisën rrugën emigrimit për në Evropën Perëndimore për të përmbushur, edhe ëndrrën e tij të bëhet një pilot. Ai tani është duke punuar në aerokompaninë Sierra West Airlines, e cila vepron me ekskluzivitetin e aeroplanëve "Jet" dhe ngarkesave nëpërmjet fluturimeve ajrore.

Xhejms Berisha, është diplomuar në Akademinë e Flotës Ajrore në Vero Beach, Florida. Për të fituar orët fluturimit, Berisha ka bërë disa fluturime të cilat fillojnë prej nga një orë deri në fluturime me nga shtatë e dhjetë orë, prej Fairbanks, Alaska, e deri në Shkup, Maqedoni. Këtë herë ai nuk është duke fluturua me aeroplan për të mbledhur orët e fluturimit. Ai po financon vetë udhëtimin e tij me qëllim që të "bisedojë" nga ajri me njerëzit e Amerikës Qendrore dhe të Jugut, dhe për t'i inkurajuar ata për të njohur pavarësinë e Kosovës.

**Intervistë me këngëtarin BLEDI**



fundi marsit  
**Pse mendoni që ne emisionin pershendetje nga gurma popullore jeni shumë i kerkuar?**  
-Jam shumë i kerkuar sepse unë percejell muziken e vertet shqiptare ashtu sic eshte dhe Radio Nacional.  
**Si e kaloni kohen e lirë?**  
- Kohen e lirë në kafe mes miqve dhe kolegeve  
**Kë do te donit te falenderonit?**  
- Te gjithë ata që me mbeshtesin i falenderoj por në vecanti z.Flamur Buçpapaj dhe Zotin që ben te mundur keto emisione kaq te bukura ne Radio Nacional ne 93.6 mhz.

**Si e ndjeni veten që keni nxjerr ne treg dy albume?**

- Vetem e ndjej shumë mirë sepse eshte pritur mirë nga simpatizantet e muzikes popullore  
**Me ke keni bashkpunuar per albumet?**  
- Kam bashkëpunuar me Sajmir Çilin, Jorgo Papingjin, Gent Lakon etj.  
**Cilat jane planet per te ardhmen?**  
- Se shpejti albumi me i ri nga

**Per çdo gezim tuajin familjar prenontojeni Bledin me grupin e tij në 0682085474 si dhe 0682123856**

**Pergatiti: ENEA CENKO**

**Intervistë me këngëtarin PERLAT SHEQERI**



**E zgjedhet vet profesionin e kengetarit apoua sugjeruan te tjeret?**

- E kam dhuratë nga tezja ime që me dhuroi ciftelin, pastaj zeri eshte dhuratë e Zotit.  
**Cila ka qen kenga me e bukur që te cilen e keni pelqyer edhe vete?**  
Kenga me bukur per mua eshte kenga " Më kaloj jeta fukara".  
**Me cilin nga kantautorët dhe kompozitorët keni bashkëpunuar?**  
Kam bashkëpunuar me Edmond Zhulalin, Jorgo Papingjin, Takun etj  
**Me çfare po mereni momentalisht?**

**Ne çfare moshe keni filluar te kendonit?**

- Kam filluar te kendoj që ne moshen 6 vjec. Jam nga Puka dhe meqe jam nga veriu koncertet e para janë me cifteli.  
**Cili ka qen vidioklipi i parë dhe ne çfar viti?**  
- Vidioklipi i parë ka qenë ne vitin 1999-2000 dhe ka qenë kenga " Më kaloj jeta fukara".

-Po bashkpujoj me nje kolegen time, por do e le surprize.

**Perlat Sheqeri eshte disponueshem per çdo gezim tuajin familjar kontaktoni ne 0682186965**

**Pergatiti: ENEA CENKO**

**MBI ARRITJET LETRARE TË FREDERIK TURNERIT**

**vijon nga faqja 17**  
në origjinal të dalin jashtë konceptit "ur-language" dhe të përjetojnë frymëzimin origjinal të poetit, strukturën e simboleve dhe ritmit si të ishte pjesë e saj. Tani ky frymëzim përbën rrënjën "ur-language" për poemën e shkruar prej tij në gjuhën e vet. Ndërkohë metrika, ritmi dhe ndryshimi i muzikalitetit në origjinal ashtu sikurse muzika dhe paraqitja vizuale nuk mbështeten në vepra në lidhje me kulturën si mjete për përthyesin. Turnerit e kupton këtë proces të simbolizuar nga miti i Orfeut dhe gjithë poetëve të tjerë të cilët e ndërmarin udhëtimin e tyre mitik dhe mistik drejt ferrit dhe fundit, lirës dhe dajres së mistikut apo raketakes apo flautit apo zarit të artë, ku hajmalia mundëson të kalohet përmes portave të botës së nëndheshme e cila përbëhet nga arti i metrikës dhe formës poetike. Një nga nënkuptimet e kësaj forme përthimi është se Turnerit i shih

ndarjet midis vendeve, jo vetëm si pengesa tërësisht të pafundme, por edhe si zhgënjime për të shkruar në brendësi të ndryshimeve të gjuhës së nënës, drejt thellësisë së gjuhës së zakonshme "ur-language". Ndaj është pranuar se muzika është një gjuhë e përbashkët për të gjithë njerëzit dhe po kështu mund të jetë gjithashtu edhe ilustrimi figurativ. Turnerit ka nxjerrë të njëjtin universalitet nga arti i përthimit të poezisë dhe pas kësaj ka sjellë ndër mend se rregullsia njohëse e gjuhës nëse kontrollohet nga poetët mund të përdoret më tepër për të bashkuar se sa për të ndarë njerëzimin. Vepra e Turnerit është përthyer në frëngjisht, gjermanisht, japonisht, spanjisht, hungarisht, italisht, rumanisht, maqedonisht, rusisht, shqip, turqisht, në gjuhën vietnameze dhe në gjuhë të tjera. Vepra e një poeti sikurse ka thënë Mallarme shërben për të pastruar dialektin e fiseve. Pas disa diskutimeve Turn-

eri e ka përmbushur misionin e tij në mënyrë të përsosur. Ai nuk është shumë i njohur për vlerat e tij në epokën e përdorimit të zhargoneve, Heidegger (Heidegger) dhe shpërbërja (deconstruction), ku vlerat janë më së shumti pothuajse tepër të përditshme, si në përdorimin e saktë dhe të qartë të fjalëve ekzistuese. Ai citohet psh nëntë herë në Fjalorin e Trashëgimisë Amerikane, me këto kuptime: "kryesore", "përmbajtje", "qartësi", "rrjedhshmëri", "kuptim", "thellësi", "rast", "reference" dhe "regjistër". Pjesë e punës së Turnerit si poet publik ka qenë për të shpjeguar përdorimin e saktë të fjalëve, për t'i paraqitur në shprehje e zakonshme, të përdorshme, në shprehje të rralla apo mënyra e përdorimit të fjalëve të vjetra. Ai duket se ka përshtatur në mënyrë instiktive teknikën e Shekspirin në bashkimin e fjalëve të mësuara me një fjalë, shprehje të zakonshme (diçka e tillë si tek Ted Hughes kur lavdëron me par-

athënien e tij Sonetet e Shekspirin) duke u dhënë dorë lexuesve që të thellohen në kuptimin e fjalës së zakonshme, ndërsa vendosen në mjedisin e njohur, atë më të ndërlikuarin. Fjalori i veprave të Turnerit mund të jetë më i pasuri ndër poetët e gjallë. Në këtë pikëpamje, erudicionit të tij nuk i mungon imagjinata, por gëzimi i plotë në pasurimin e gjuhës dhe dëshira për ta komunikuar atë, për të mësuar fjalë të reja si pjesë e ngjarjes së dytë të veprës së Adamit, kur u vendosi emra kafshëve. Dashuria e Turnerit për shkencën ka po të njëjtat rrënjë. Ai do të citohet në mënyrë të admirueshme nga gazeta e Institutit Amerikan të Fizikës në një farë mënyre si për të menduar se ka ndihmuar në rivendosjen e marrëdhënieve midis shkencës dhe artit të historisë humaniste.

Shekulli ynë i njëzet e një do të njihet me figurat e reja, tingujt e kohës së shkruar dhe realiteti ynë virtual do të jetë e shkuara jonë e plotë njerëzore-çfarë tjetër

mbi të gjitha mbetet më e rëndësishmja për t'u zbuluar?... Një nga vargjet bashkëkohore mbart atë që ne duhet t'i kushtojmë vëmendje të ardhmes sepse me të do të kalojmë jetën. Ndoshta do të ishte më e qartë të shprehemi se duhet t'i kushtojmë vëmendje së kaluarës, për të njëjtat arsye.

Turneri më vonë ka mbërthyer rolin e poetit publik. Ai ka ndërlikuar poezinë (dhe forma të tjera letrare) me shkencat humane dhe njeriun me shkencat natyrore, e ka rivendosur artin e poezisë dhe e ka bërë atë të mundshëm për t'u komunikuar me vende të tjera në botë. Duke kuptuar metrikën e artit të poetikës dhe të tregimit, ka nxjerrë artin e poezisë nga qoshja e përkushtuar letrare për profesionistë dhe e ka rivendosur për t'u shitur, si provë, në shtëpinë e adhurimit, në sheshin publik dhe në familjen njerëzore.

**Përktheu nga anglishtja IRENA PAPIINGJI**